



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 4278/Prot.
15

Tiranë, më 25/2/2013

URDHËR
Nr. 08 datë 25/02 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 "*Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "*Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të Kontrolluesit, Spitali Universitar Obstetrit-Gjinekologjik "*Mbretëresha Geraldinë*" Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhrit nr. 2 datë 08.01.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer inspektimi administrativ pranë Kontrolluesit Spitali Universitar Obstetrit-Gjinekologjik "*Mbretëresha Geraldinë*", lidhur me trajtimin e ankesës të datës 20.12.2012 të shtetasit N.M mbi përdorimin e të dhënave biometrike "*gjurma e gishtit*" për identifikimin e prezencës në punë të punonjësve.

Objekti i inspektimit administrativ ishte:

- Verifikimi i ankesës së shtetasit N.M drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e cila lidhet me përdorimin e të dhënave biometrike (*gjurma e gishtit*) për identifikimin e prezencës në punë të punonjësve.

Me urdhër të Drejtorit të këtij Institucioni të datës 04/12/2012, është vendosur përdorimi i sistemit për identifikimin e një pjese të punonjësve përmes përdorimit të të dhënave biometrike "*gjurma e gishtit*" me qëllim evidentimin e prezencës në punë të personelit mjekësor. Ky fakt është parashikuar të pasqyrohet në ç'do kontratë pune individuale me punonjësit. Ky sistem përdoret për 54 nga 378 punonjës të cilët janë kryesisht drejtues të departamenteve të këtij Kontrolluesi, sistemi biometrik i aksesit përdoret në hyrje të godinës së administratës.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se, përpunimi i këtyre të dhënave biometrike mund të bëhet vetëm në raste të veçanta (*siguria e njerëzve dhe e pronës, mbrojtja e të dhënave sekrete, sekretit tregtar etj*), për të bërë të mundur identifikimin dhe krahasimin e karakteristikave të individëve.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se, përpunimi i të dhënave biometrike "*gjurma e gishtit*" duhet të bëhet mbi një bazë ligjore dhe vetëm atëherë kur është vërtet i nevojshëm për qëllime të caktuara, qëllime të cilat nuk mund të arrihen me mjete dhe mënyra të tjera. Përdorimi i të dhënave biometrike "*gjurma e gishtit*" duhet të realizohet duke

respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private, të drejta këto të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për “Mbrotjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut” dhe ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrotjen e të Dhënave Personale”.

Kontrolluesi Spitali Universitar Obstetrit-Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” përpara se të vendoste përpunimin e të dhënave biometrike “gjurma e gishtit” për identifikimin e prezencës në punë të punonjësve:

- duhet të kishte njoftuar Komisionerin për Mbrotjen e të Dhënave Personale për përpunimin e të dhënave personale biometrike “gjurma e gishtit” për punonjësit, por duke mos njoftuar nuk ka mundur të njohjen e Komisionerit me aktet e brendshme dhe masat e sigurisë që do të përdoren gjatë përpunimit të këtyre të dhënave.

-duhet të informonte në mënyrë të qartë punonjësit në lidhje me qëllimin e mbledhjes, mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses dhe si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij.

-duhet të hartonte rregulla ku të përcaktonte mënyrat, kriteret, qëllimin, masat për ruajtjen e sigurisë për përpunimin e të dhënave biometrike “gjurma e gishtit”. si dhe konfidencialitetin

-duhet të hartonte një kontratë me kompaninë private që mirëmban nga ana teknike sistemin për përpunimin e të dhënave biometrike “gjurma e gishtit”, lidhur me mbrotjen e të dhënave personale të punonjësve të tij.

1. Kontrolluesi Spitali Universitar Obstetrit-Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” nuk ka njoftuar pranë zyrës së Komisionerit , përpunimin e të dhënave biometrike “gjurma e gishtit” për kategorinë “punonjës”, duke shkelur nenin 21 pika 1 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrotjen e të Dhënave Personale”... “ Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënave për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.

2. Kontrolluesi Spitali Universitar Obstetrit-Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” nuk ka informuar në mënyrë të qartë punonjësit në lidhje me qëllimin e mbledhjes, mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses dhe si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij, duke shkelur nenin 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrotjen e të Dhënave Personale”... .. “Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënave personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënave, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij”.

3. Kontrolluesi Spitali Universitar Obstetrit-Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” nuk ka hartuar një rregullorë ku të jenë të përshkruara procedurat që ndiqen në sistemin e vendosur për përdorimin e të dhënave biometrike “gjurma e gishtit”, aksesin, masat për mbrotjen e sistemit, si dhe sigurinë e të dhënave personale .

Në këto raste është shkelur neni 27/1 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrotjen e të Dhënave Personale”...Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënave personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të pa autorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi”.

4. Kontrolluesi nuk ka një kontratë të shkruar me subjektin i cili mirëmban nga ana teknike sistemin e vendosur për përdorimin e të dhënave biometrike “*gjurma e gishtit*”, ku të jenë përshkruar detyrime lidhur me mbrojtjen e konfidencialitetit për të dhënave personale të punonjësve, duke shkelur nenin 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”... “*Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.*”

Sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, si dhe 107-109 të K. Pr. Administrative ;

URDHËROJ

1. Të pezullohet menjëherë përdorimi i sistemit të vendosur për përpunimin e të dhënave biometrike “*gjurma e gishtit*” për vërtetimin e prezencës në pune të punonjësve;
2. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, të informojë në mënyrë të qartë punonjësit në lidhje me qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave biometrike “*gjurma e gishtit*”;
3. Në zbatim të nenit 21, pika 1 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, të njoftohet pranë Komisionerit me anën e “*formularit të njoftimit*”, mbledhja dhe përpunimi i të dhënave biometrike “*gjurma e gishtit*”, aktet e brendshme dhe masat e sigurisë për përpunimin e këtyre të dhënave, si dhe opinionin dhe mendimi i punonjësve dhe i sindikatës së punonjësve, në lidhje me qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave biometrike “*gjurma e gishtit*”;
4. Në zbatim të nenit 27, pika 1 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”:
 - bazuar në ligj të hartohet rregullore lidhur me mbledhjen, përdorimin, procedurat, aksesin, masat për mbrojtjen e sistemit, sigurinë edhe konfidencialitetin për përpunimin e të dhënave biometrike “*gjurma e gishtit*”.
 - të lidhet kontratë me subjektin i cili mirëmban nga ana teknike sistemin e përdorimit të të dhënave biometrike “*gjurma e gishtit*”, ku të jenë përshkruar rregulla lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve;
5. Në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, në kontratën me subjektin i cili mirëmban nga ana teknike sistemin e përdorimit të të dhënave biometrike “*gjurma e gishtit*”, të jenë përshkruar detyrime lidhur me konfidencialitetin e të dhënave personale të punonjësve;
6. Për plotësimin e këtij detyrimi të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
7. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, sipas të cilit... “*Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të*”

rekomandimeve të tij,vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

8. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

